

Instituti GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Mitrovicës - 2013

Maj, 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive.....	3
1. Hyrje .....	4
2. Problemet në Komunën e Mitrovicës.....	5
3. Performanca buxhetore e Komunës së Mitrovicës.....	7
4. Investimet kapitale .....	10
5. Aktivitetet e Prokurimit Publik .....	13
6. Administrata e Komunës së Mitrovicës.....	14
7. Arsimi në Komunën e Mitrovicës.....	15
8. Transparenca në Komunën e Mitrovicës.....	16
9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009.....	18
10. Burimet .....	22

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Mitrovicës gjatë tri viteve të kaluara ka gëzuar mbështetje të gjerë nga donatorët ndërkombëtar në realizimin e disa projekte madhore. Vlera e mjeteve të investuara nga donatorët gjatë tri viteve kalon shifrën e 30 milionë eurove, apo dyfish më shumë se sa vlera e investimeve kapitale të bëra nga vetë Komuna e Mitrovicës gjatë kësaj periudhe. Edhe përkundër kësaj, mitrovicasit vazhdojnë të përballen me probleme pothuajse të njëjta me ato të periudhës së para zgjedhjeve lokale të 2009. Mungesa e ujit të pijes, prezencës së shtuar të mbeturinave nëpër qytet, pamundësia e lëvizjeve së udhëtareve me transport publik apo me transport të rregulluar, rrugë të paasfaltuara, rrugë të dëmtuara, ndotja e ambientit, mungesa e mirëmbajtjes nëpër ndërtesa publike, pamundësia e ofrimit të shërbimeve mjekësore, etj., janë vetëm disa nga problemet aktuale të banorëve të Komunës së Mitrovicës.

Gjatë kësaj periudhe, 2010-2012, Komuna e Mitrovicës renditet e komuna e tretë në nivel vendi, pas Gjilanit dhe Skënderajt, për shkallën më të lartë të borxhit publik. Mbi 1.3 milionë euro kjo komunë konsiderohet t'u këtë borxh operatoreve privat me të cilët ka kontraktuar punë dhe shërbime pa pasur mbulim financiar. Krahas hyrjes në borxh, Komuna e Mitrovicës ka përmyllur vitin 2012 me rënien e të hyrave vetanake në rreth 300.000 euro.

Gjatë vitit 2012, gjithsej shuma e mjeteve që Komuna e Mitrovicës ka investuar për zgjerimin dhe rregullimin e trotuareve ka qenë 49.000 euro, përderisa për të njëjtën periudhë të këtij viti derivate për vetura janë shpenzuar mbi 69.000 euro. Njësoj rezultojnë krahasimi i shpenzimeve mes investimeve në instalimin e rrjetit të kanalizimit. Kësisoj, gjatë gjithë vitit 2012 shuma e investuar për rregullimin e kanalizimeve ka qenë 14.472 euro, përderisa për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve gjatë 2012 janë shpenzuar 40.674 euro.

Nga gjithsej 1.862 persona sa llogariten të punësuar në administratën komunale, në sistemin e arsimit dhe atë të shëndetësisë, vetëm 535 janë me diploma universitare, përderisa 1.327 persona janë me shkollim fillor, të mesëm ose me shkollim të lartë.

Komuna e Mitrovicës, sikurse Peja, ka numrin më të madh të drejtorive komunale, gjithsej 14. Asnjë nga drejtoritë nuk udhëhiqet nga femrat.

Në 2010-2012, Komuna e Mitrovicës ka lidhur 603 kontrata nëpërmjet procedurave të prokurimit publik dhe vetëm 73 i ka dërguar për publikim në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP). Kjo e bënë këtë komunë me nivelin më të ulët të publikimit të njoftimeve që lidhen me prokurimin publik. Edhe me i vogël është numri i njoftimeve që kjo komunë ka në faqen e saj zyrtare që lidhen me tenderët e shpallur publik.

Për tri vite, 2010-2012, Komuna e Mitrovicës për telefona mobil e fiks ka shpenzuar 173.437 euro, për darka e dreka 103.376 euro, derivate për vetura 204.886 euro, ndërsa për riparimin dhe mirëmbajtjen e veturave zyrtare gjatë tri viteve të fundit komuna e Mitrovicës ka shpenzuar 138.769 euro.

# 1. Hyrje

Komuna e Mitrovicës udhëhiqet nga Kryetari z.Avni Kastrati. Ai është zgjedhur në këtë pozitë në zgjedhjet e fundit lokale në nëntor të vitit 2009 duke përfaqësuar Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Para ushtrimit të kësaj pozite z.Kastrati nuk ka pasur ndonjë funksion të mëhershëm në pushtetin lokal, përjashtimisht kryesimit të komisionit për përpilimin e projekteve zhvillimore në konferencën e donatorëve të propozuara për Mitrovicën (2008). Marrja e mandatit nga z.Kastrati është mundësuar nëpërmjet mbajtjes së balotazhit mes kryetarit aktual dhe kandidatit për kryetar nga Aleanca Kosova e Re, Nexhmedin Spahiut. Pas këtij raundi, për kryetar të komunës së Mitrovicës, është zgjedhur Avni Kastrati, me afërsisht një mijë vota më shumë se kundër kandidati nga AKR.<sup>1</sup> Me konsolidimin e mandatit në fillim të vitit 2010, Avni Kastrati ka hyrë në koalicion me AKR duke i ofruar tri drejtori. AKR udhëheq me Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Bujqësisë dhe me Drejtorinë për Mbrojtjen e Ambientit. Në gjysmën e muajit janar të këtij viti, Drejtori për Mbrojtjen e Ambientit, Gani Rrustemi ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë dhe që nga ajo kohë kjo Drejtori është pa udhëheqës. Gani Rrustemi në ndërkohë është zgjedhur drejtor i shkollës së mesme ekonomike “Hasan Prishtina” në Mitrovicë.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, Mitrovica ka regjistruar 71.909 banorë.<sup>2</sup> Për nga numri i banorëve, Mitrovica renditet e teta në vend.<sup>3</sup> Llogaritja e numrit të banorëve në Mitrovicë është bërë pa u përfshirë popullata e pjesës veriore, e cila, për shkaqe të njohura, ka refuzuar të marr pjesë në regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave. Kjo pjesë administrativisht bie nën përgjegjësinë e Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut, e cila pritet të shndërrohet në komunë.<sup>4</sup> Deri tani Komuna e Mitrovicës, duke u llogaritur vetëm pjesa jugore, ka marr grant nga niveli qendror për 90.000 banorë.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e raundit të dytë të rezultateve për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 15. Burimi: [http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk\\_raundi%202.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk_raundi%202.pdf)

<sup>2</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>3</sup> Pas Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Gjakovës, Gjilanit, Podujevës dhe Ferizajt

<sup>4</sup> Instituti GAP. Letërnjoftimi për komunat veriore. Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut. Janar, 2013. Fq 14 & 17. Burimi: [http://www.institutigap.org/documents/34188\\_Leternjoftimiperkomunatveriore.pdf](http://www.institutigap.org/documents/34188_Leternjoftimiperkomunatveriore.pdf)

<sup>5</sup> Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Fq 22. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

Ekzekutivi i Komunës së Mitrovicës përbëhet nga 14 drejtori.<sup>6</sup> Me këtë numër të drejtorive, Mitrovica krahas Komunës së Pejës, randitet si komuna me numrin më të madh të drejtorive. Asnjë nga 14 Drejtori nuk udhëhiqet nga femrat.

Komuna e Mitrovicës është komuna e dytë në vend, pas Komunës së Lipjanit, e cila Zyrën e Prokurimit Publik e ka të rregulluar në nivel të drejtorisë. Në të gjitha komunat, mirëqenia sociale është e inkorporuar në Drejtorinë e Shëndetësisë, ndërsa në Mitrovicë kjo është përfshirë brenda Drejtorisë për Integritet Evropian. Karakteristikë tjetër e organizimit të drejtorive në Mitrovicë është edhe funksionimi i Drejtorisë për Mbrojtjen e Ambientit, drejtori e cila nuk haset në komunat tjera.

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës përbëhet prej 41 asambleistëve: 14 nga PDK, nëntë nga LDK, shtatë nga AKR, gjashtë nga AAK, dy nga LDD, dhe me nga një asambleistë janë përfaqësuar Partia e Drejtësisë (PD), Partia Reformiste (ORA) dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP).<sup>7</sup> Pas zgjedhjeve, struktura politike e Kuvendit Komunal ka ndryshuar si rezultat i kalimeve të asambleistëve nga një subjekt politik në tjetrin. Kësisoj, PDK aktualisht ka 15 përfaqësues, LDK ka nëntë përfaqësues, AKR shtatë, AAK katër, dy LDD, dy asambleistë të pavarur dhe me nga një asambleist janë të përfaqësuar Partia e Drejtësisë (PD) dhe Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP).<sup>8</sup> Partitë që udhëheqin me Komunën e Mitrovicës, PDK dhe AKR, në Kuvendin Komunal kanë gjithsej 22 ulëse apo shumicën e thjeshtë.

## 2. Problemet në Komunën e Mitrovicës

Përveç problemeve të përgjithshme që nuk lidhen me përgjegjësitë direkte të komunave, si papunësia, varfëria, mungesa e rrymës, banorët e Komunës së Mitrovicës përballen edhe me probleme si mungesa e ujit të pijes, mbeturinat nëpër qytet, pamundësia e lëvizjeve së udhëtareve me transport publik apo me transport të rregulluar, rrugë të paasfaltuara, rrugë të dëmtuara, ndotje e ambientit, mungesa e mirëmbajtjes nëpër ndërtesa publike, pamundësia e ofrimit të shërbimeve mjekësore, si dhe në disa raste është hasur dukuria e dëmtimit të infrastrukturës rrugore nga cilësia e dobët e punimeve të kryera. Territori i Komunës së Mitrovicës numëron 36 fshatra.<sup>9</sup> Pjesa dërrmuese e tyre janë pa sistem të kanalizimit, ujësjellësit si dhe vetëm një numër i vogël i tyre kanë rrugë të asfaltuara.

---

<sup>6</sup> Emërtimet dhe përshkrimin e drejtorive mund ta gjeni në këtë link: <http://kk.rks.gov.net/mitrovica/Municipality/Departments.aspx>

<sup>7</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 12. Komuna e Mitrovicës. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/komune/ResultsByMunicipality.pdf>

<sup>8</sup> Bisedë me Safet Kamberin asamblistë i Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga radhët e LDK-se. Biseda është zhvilluar me date 24.04.2013.

<sup>9</sup> Kuvendi i Kosovës. Ligji për Ndarjen e kufijve Administrativ të Komunave. Nr.03/L-041. Fq 17. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L041\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L041_al.pdf)

Banorët e Mitrovicës në tri vitet e fundit janë përballur me mungesë të theksuar të ujit të pijes, veçmas gjatë sezonit të verës. Nga ky problem janë përballur edhe zonat urbane të qytetit. Autoritetet lokale në bashkëpunim me Zyrën Ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe shtetit të Luksemburgut kanë nisur së investuari afro 15 milionë euro në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese të ujit dhe gjenerimin e tij në zonat e banuara. Kjo besohet që do të ndikojë në përmirësimin e gjendjes së tanishme nga mungesa e ujit të pijes.

Infrastruktura rrugore në qytetin e Mitrovicës nuk është në gjendje të mirë. Pothuajse në të gjitha rrugët e qytetit hasen gropa dhe dëmtime tjera të cilat shkaktojnë telashe për ngasësit e automjeteve. Kjo gjendje ka mbetur e njëjtë që disa vite edhe përkundër investime kohë pas kohe të buxhetit komunal në mirëmbajtjen e rrugëve lokale. Gjendje e njëjtë haset edhe në trotuaret e këtij qytetit. Në shumë zona janë dëmtuar kubëzat e betonit.

Qyteti i Mitrovicës mund të llogaritet si njëri ndër qytetet më të ndotura në nivel të komunave. Në shumë zona të kësaj komune, duke përfshirë edhe zonat urbane, vërehen të shpërndara mbeturinat inerte. Kontejnerët e mbeturinave pastrohen dy herë gjatë javës. Në gjithë qytetin vërehen rrallë të vendosura shporta për hedhjen e mbeturinave. Kjo gjendje është e tillë edhe përkundër që Komuna e Mitrovicës është e vetmja në nivel të komunave të vendit e cila ka të themeluar Drejtorinë për Mbrojtjen e Ambientit.

Komuna e Mitrovicës nuk e ka të rregulluar transportin e udhëtarëve. Kjo vie nga mungesa e një kompanie publike komunale të trafikut urban. Udhëtimet e qytetarëve brenda vendbanimeve të Mitrovicës mundësohet nëpërmjet auto-taksive legale dhe ilegale.

Pjesa dërmuese e zonave të banueshme në Mitrovicë janë pa ndriçim publik. Komuna ka bërë investime të pakta në zgjerimin e zonave të cilat mbulohen me ndriçim publik. Gjatë viteve 2010-2012, Mitrovica për ndriçim publik ka investuar më pak se 250.000 euro. Kësisoj, pa ndriçim publik janë një pjesë e konsiderueshme e lagjeve në zonën e quajtur "Iliridë". Njësoj është gjendja edhe në zonën përreth stadiumit të qytetit "Adem Jashari" si dhe përgjatë rrugës "Sami Gashi".

Komuna e Mitrovicës në pjesën dërmuese të rasteve nuk mund të ofrojë shërbime adekuate mjekësore. Në disa raste mungojnë kuadrot e specializuara që do të mund të angazhoheshin për shërbime, e në disa raste të tjera mungojnë mjetet adekuate për ofrimin e shërbimeve. Kjo komunë nuk ka asnjë kirurg, psikiatër apo anesteziolog. Për pacientët kujdesen dy kirurg, ku së bashku me një anesteziolog vijnë nga QKUK një herë në javë. Për këta të fundit nga buxheti komunal duhet të paguhet ekstra udhëtimi dhe shujtat ditore. Reparti i stomatologjisë në pjesën dërmuese të kohës është jashtë funksionit dhe nuk mund të ofrojë shërbime për shkak të dëmtimit të aparaturave mjekësore. Si rezultat i kësaj, mitrovicasit edhe për nevojat më të vogla mjekësore duhet të u drejtohen ordinancave private në këtë qytet.

### 3. Performanca buxhetore e Komunës së Mitrovicës

Gjatë viteve 2010-2012, Komuna e Mitrovicës ka shpenzuar buxhet afro 52 milionë euro. Llogaritur edhe me shumën e mjeteve që kjo komunë ka në dispozicion gjatë vitit 2013, rezulton se Mitrovica gjatë këtij mandati katër vjeçar (2010-2013) do të shpenzojë afro 68 milion euro. Shuma më e madhe e këtyre mjeteve janë dedikuar për paga, pastaj për investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe në linjat tjera të buxhetit, si për subvencione dhe shpenzime komunale.

Tabela nr.1: Orientimi i mjeteve financiare nga Komuna e Mitrovicës gjatë ketër viteve (2010-2013) llogaritur në total

Fushat	Shuma
Për investimet kapitale	19.295.398
Për paga	38.126.552
Për subvencione	2.099.876
Për shpenzime komunale	1.713.236
Për mallra dhe shërbime	5.700.564
<b>Gjithsej</b>	<b>66.935.626</b>

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Mitrovicës sipas viteve (2010-2013)

Kategoria	Plani 2013	2012	2011	2010
Investime Kapitale	3.832.360	5.598.117	4.641.970	5.222.951
Mallra dhe shërbime	1.450.230	1.550.362	1.405.028	1.294.944
Subvencion dhe transfere	679.880	762.036	369.033	288.927
Shpenzime komunale	422.222	434.482	454.974	401.558
Paga	8.723.913	9.904.445	11.286.610	8.211.584
<b>Gjithsej</b>	<b>15.108.605</b>	<b>18.250.442</b>	<b>18.157.615</b>	<b>15.419.964</b>

Komuna e Mitrovicës është e treta komunë në nivel të komunave të vendit për shkallën më të lartë të borxhit publik, përkatësisht faturave të papaguara. Hyrja në borxh vie nga kontraktimi i punëve dhe shërbimeve nga komuna me operatorët e ndryshëm privat dhe mos pagimi i faturave.

Tabela nr.3: Pasqyrimi i katër komunave të vendit të cilat kanë shkallën më të lartë të borxhit

Komunat	Gjilani	Skenderaj	Mitrovica	Shtërpca
<b>Vlera e borxhit</b>	3.291.930	1.503.086	1.301.000	1.076.158

Krahas rritjes së nivelit të borxhit, Mitrovica ka përmbyllur vitin 2012 më rënien më të madhe të të hyrave komunale në tri vitet e fundit.

Tabela: nr.4: Ecuria e të hyrave komunale në katër vitet e fundit në Komunën e Mitrovicës

Viti	2012	2011	2010	2009
<b>Shuma (euro)</b>	1.543.511	1.834.136	1.851.630	1.715.910

Nga të dhënat e mësipërme vërehet se Komuna e Mitrovicës ka pasur rënie të të hyrave gjatë vitit 2011, por rënia më e theksuar ka qenë në vitin 2012. Nëse krahasohen të hyrat mes vitit 2011 dhe vitit 2012, rezulton se gjatë vitit të fundit rënia e të hyrave ka qenë rreth 300.000 euro.

Tabela: nr.5: Pasqyrimi i të hyrave komunale gjatë vitit 2012 sipas sektorëve dhe krahasimi i tyre me vitin 2011 dhe 2010

Linja e të hyrave	Shuma (euro)		
	2012	2011	2010
Të hyra nga certifikatat e lindjes	34.181	26.150	19.028
Të hyra nga certifikata e kurorëzimit	8.965	9.031	9.870
Të hyra nga certifikata e vdekjes	718	682	677
Të hyra nga verifikimi i dokumenteve	80.649	105.174	124.348
Të hyra nga pjesëmarrja në tenderë	00	975	10.119
Të hyra nga pranimi teknik i lokaleve	4.050	7.145	6.173
Të hyra nga inspekcioni	1.462	1.720	3.947
Të hyra nga aplikimi i taksës për biznes	42.562	82.492	90.075
Të hyra nga tatimi në pronë	356.335	369.216	307.539
Të hyra nga regjistrimi i biznesit	00	2.010	2.280
Të hyra nga destinimi i pronës	220	625	150
Të hyra nga regjistrimi i automjeteve	81.820	92.400	80.420
Të hyra nga qiraja në tokat bujqësore	2.420	5.587	12.933
Të hyra nga parkingjet publike	9.321	8.728	9.490
Të hyra nga regjistrimi i trashëgimisë	38.350	3.200	00
Të hyra nga matja e parcelave	17.014	37.754	17.156
Të hyra nga lejet e ndërtimit	132.824	106.931	34.708
Të hyra nga ndërrimi i tokës	333.541	409.159	597.561
Të hyra nga reklamat	22.408	24.677	27.897
Të hyra nga shfrytëzimi i hapësirës publike	4.893	20.941	6.388
Të hyra nga qiraja në objektet afariste	51.772	65.449	24.886
Të hyra nga qiraja në objektet publike	9.262	6.621	6.684
Të hyra nga biblioteka	2.801	2.386	2.736
Të hyra nga qiraja në objektet sportive	7.174	7.863	7.625
Të hyra nga arsimit	127.152	130.787	105.710
Të hyra nga shëndetësia	68.691	53.516	42.756
Të hyra nga administrata e UNMIK-ut në veri	21.725	120.995	100.078
Të hyra nga dënimet në trafik	67.016	121.605	182.246
Të hyra nga dënimet nga gjykatat	16.185	12.325	18.150
<b>Gjithsej</b>	<b>1.543.511</b>	<b>1.834.136</b>	<b>1.851.630</b>



Komuna e Mitrovicës aktualisht ka në dispozicion një buxhet prej mbi 15 milion euro. Nga kjo shumë, rreth 1.5 milion euro janë të hyra vetanake, ndërsa pjesa tjetër e buxhetit përbëhet nga granti i Qeverisë për komuna, nga granti specifik për arsim dhe shëndetësi si dhe nga qarkorja e programuar për paga. Deri në fund të vitit 2012, Komuna e Mitrovicës ka menaxhuar edhe shumën e mjeteve financiare për pjesën veriore të qytetit për paga dhe një pjesë për investime kapitale. Nga fillimi i këtij viti, kjo shumë (rreth 2.8 milionë euro) ka kaluar nën kompetencë të Zyrës Administrative të Mitrovicës së Veriut.<sup>10</sup>

Tabela nr.6: Krahasimi i shpenzimeve në disa kategori në linjën për mallra dhe shërbime mes vitit 2012, 2011 dhe 2010

Kategoria	2012	2011	2010	Gjithsej
Shpenzimet në telefonin mobile	23.551	36.475	30.625	90.651
Shpenzimet në telefoni fikse	28.551	27.225	27.010	82.786
Shpenzimet për darka dhe dreka zyrtare	37.956	39.220	26.200	103.376
Shpenzimet e marketingut	40.938	12.263	15.289	68.490
Shpenzimet derivate për vetura	69.511	76.226	59.149	204.886
Shpenzime për mëditje jashtë vendit	23.561	17.425	17.401	58.387
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	23.691	9.612	3.829	37.132
Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve	40.674	65.234	32.861	138.769

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në raportin për vitin 2011 ka gjetur një rast kur Komuna e Mitrovicës ka paguar shumën prej 14.174 eurove për naftë operatorit privat "Graniti Petrol", përderisa përshkrimi i shpenzimit ishte bërë në emër të pastrimit në pjesën veriore të Mitrovicës. Po ashtu sipas këtyre të dhënave, projekti "Rindërtimi i shtëpive në veri të Mitrovicës" ishin riparuar dy shtëpi në shumë prej 49.921 eurove. Komuna e Mitrovicës nuk ka zhvilluar procedura të prokurimit, por ka lidhur aneks kontrata duke u bazuar në kontratën bazë të vitit 2009. Pas përfundimit të shtëpive, Auditori nuk ka gjetur ndonjë raport me shkrim nga komisioni për pranim të punëve. Ky institucion konstaton prerazi se te rasti i Komunës së Mitrovicës haset dobësi dhe qasje jo e duhur e planifikimi të buxhetit. Buxheti nuk bazohet në analizat e duhura paraprake dhe nuk harmonizohet me aktivitetet operative të komunës. Si rezultat i kësaj, një pjesë e buxhetit nuk ekzekutohet dhe niveli i borxhit rritet.<sup>11</sup>

<sup>10</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2011. Fq 11 Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KMT\\_2011\\_Shqip\\_909111.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KMT_2011_Shqip_909111.pdf)

<sup>11</sup> Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2011. Fq 14-16. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KMT\\_2011\\_Shqip\\_909111.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KMT_2011_Shqip_909111.pdf)

Tabela nr.7: Shpenzimet në energji elektrike, ujë dhe mbeturina nga Komuna e Mitrovicës në tri vitet e fundit (2010-2012)

Kategoria	2012	2011	2010
Pagesat për energji elektrike	244.031	178.378	187.189
Pagesat për ujë	100.806	93.031	94.602
Pagesat për mbeturina	29.959	92.799	66.885

## 4. Investimet kapitale

Komuna e Mitrovicës është njëra ndër përfitueset më të mëdha të donacioneve ndërkombëtare, veçmas nga Bashkimi Evropian. Shuma e mjeteve të zotuar nga donatorët për investim në këtë komunë gjatë tri viteve të kaluara kalon shifrën e 30 milionë eurove.<sup>12</sup> Këto mjete kryesisht janë të destinuara për investime kapitale. Shuma prej 30 milionë eurove është dyfish më e madhe se investimet që ka bërë Komuna e Mitrovicës gjatë viteve 2010-2012. Projektet që janë paraparë të ndërtohen nga donacionet janë zgjerimi dhe forcimi i rrjetit të ujësjellësit, duke ndërtuar paralelisht edhe një impiant për përpunimin dhe transferimin e ujit të pijes në zonat e banuara. Ka nisur së ndërtuari qendra me karakter sportiv dhe rekreativ. Së bashku me këto, nga donacionet e BE-së ka nisur renovimi i palestrës sportive “Minatori” dhe pritet të nis së ndërtuari qendra për biznes në Mitrovicë.

Komuna e Mitrovicës, buxhetin që aktualisht e ka në dispozicion për investime kapitale silllet rreth 3.8 milionë euro, apo 1.7 milionë euro me pak se një vit me herët (2012). Kjo rënie e buxhetit në investimet kapitale sipas dokumenteve zyrtare të komunës ka ardhur për faktin se deri në fund të 2012 Komuna e Mitrovicës ka menaxhuar edhe me buxhetin e paraparë për investime kapitale për pjesën veriore të qytetit e cila aktualisht udhëhiqet nga Zyra Administrative të Mitrovicës së Veriut.

Shtrirja e investimeve kapitale në Mitrovicë, sipas të dhënave zyrtare, gjatë tri viteve kanë qenë të pakta, veçmas në shtrimin dhe zgjerimin e trotuareve, kanalizimit, ujësjellësit dhe ndriçimit publik.

Tabela nr.8: Pasqyrimi i investimeve kapitale sipas viteve dhe shumat e shpenzuara në fushat të caktuara

Fushat	2010	2011	2012
Ndërtimi i rrugëve lokale në qytet dhe fshatra	1.624.810	1.823.015	1.392.545
Ndërtimi i trotuareve	124.548	102.036	49.982
Zgjerimi dhe instalimi i rrjetit të kanalizimit	217.865	200.864	14.472

<sup>12</sup> Komuna e Mitrovicës. Faqja zyrtare. Rubrika “Lajmet”. Burimi: <http://kk.rks.gov.net/mitrovica/News/Lajmet/Mitrovica-siguron-30-milione-euro-investime.aspx>

Zgjerimi dhe instalimi i rrjetit të ujësjellësit	220.176	171.798	142.397
Ndërtimi, riparimi i shtëpive të banimit, objekteve arsimore, shëndetësore dhe administrative	1.489.993	1.514.392	1.500.260
Investimet në ndriçimin publik	87.516	73.684	82.996
<b>Gjithsej</b>	<b>3.764.908</b>	<b>3.885.789</b>	<b>3.182.652</b>


Tabela nr. 9: Disa nga investimet më të mëdha të Komunës së Mitrovicës 2010-2012

Projektet kryesore të realizuara gjatë	Shuma (euro)
Rregullimi i shtratit të lumit "Trepça" dhe "Lushta"	39.950
Asfaltimi i rrugës në relacionin Fidanishtë	87.096
Rregullimi i rrugës "Mbretëresha Teutë"	51.571
Ndërtimi me kubza i rrugëve në para lagjet e Mitrovicës	297.271
Ndërtimi i rrugëve në viset rurale	270.672
Asfaltimi i rrugës për në fshatin Bare	60.952
Asfaltimi i rrugës për në fshatin Bajgorë	83.376
Asfaltimi i rrugës "Emin Duraku" ne Shipol	49.150
Ndërtimi i parkut "Artim Jashari"	40.000
Ndërtimi i poligoneve sportive në Vaganicë	39.840
Rregullimi i oborrit të brigadës së zjarrfikëseve	17.984
Ndërtimi me kubeza i rrugës në lagjen "2 Korriku"	9.987
Ndërtimi i trotuarit përgjatë rrugës "Ulqinit" Koshtovë	5.099
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Qendra"	138.687
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Bair"	62.000
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Ilirida"	89.584
Asfaltimi i rrugëve në lagjen "Ura e Gjakut"	84.000
Asfaltimi i rrugëve në "Fushë Ibër"	79.952
Ndërtimi i rrugëve në Rekë dhe Tunelin e Parë	36.000
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Vidishiq-Selac	98.197
Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Bajgorë	123.188
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Koshtovë	6.620
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vidimriq	54.999
Ndërtimi i kanalizimit të ujërave te zeza në fshatin Kqiq i Madh	50.100
Ndërtimi i kanalizimit atmosferik në rrugën e Ulqinit	49.941
Ndërtimi i trotuarit në rrugës "Ulqini"	29.768
Rindërtimi i rrugës në fshatin Koshtovë	49.046
Rregullimi i kulmit të QKMF - Mitrovicë	55.000
Rregullimi i rrugës "Sami Gashi"	34.821
Rregullimi i rrugës në fshatin Vernice	34.545
Asfaltimi i rrugës në Stan Terg	39.960
Asfaltimi i rrugës në Gushavc	34.999
Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vërnice	19.153
Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Vidimiriq	17.679
Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Stan Terg	34.434

Shtrimi i rrjetit të ujësjellësit në Fushë Ibër	29.534
Rregullimi i kanalizimit dhe rrugës ne lagjen “Kroi i Vitakut”	161.961

Rrethrotullimi i Mitrovicës i cili gjendet në hyrje të qytetit është ndërtuar dy herë. Për herë të parë ky rreth është ndërtuar nga kompania “Ideali” në viti 2007 dhe ka kushtuar afro 40.000 euro. Ndërtimi i atëhershëm i rreth rrotullimit ishte treguar jo përshtatshëm dhe si i tillë ai është dashur të rregullohet përsëri. Kështu në vitin 2011 është rirregulluar. Ky rirregullim, buxhetit të komunës i ka kushtuar 198.000 euro. Edhe përkundër investimeve shtesë, rrethrotullimi nuk mundëson zhvillimin normal të komunikacionit, ngase automjetet e mëdha, si autobusët dhe kamionët, e kanë të vështirë qarkullimin.

Grafikoni nr.1: Pasqyrimi i investimeve kapitale në Komunën e Mitrovicës për vitin 2013 sipas fushave të investimeve dhe shumës.<sup>13</sup>



<sup>13</sup> Instituti GAP. Si i shpenzon shteti paret tona. Komuna e Mitrovicës. Investimet kapitale. 2013. Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?mitrovica/2013#/~mitrovica/shpenzimet-kapitale>

## 5. Aktivitetet e Prokurimit Publik

Komuna e Mitrovicës është e dyta në vend, pas Lipjanit, e cila Zyrën e Prokurimit e ka të rregulluar në nivel të drejtorisë. Drejtor i kësaj Drejtorie është Shefki Fazliu i diplomuar në fushën e makinerisë. Dallimi në mes të Zyrës së Prokurimit dhe Drejtorisë është se zyra ka udhëheqës i cili nuk ndërrohet me ndërrimin e Kryetarit të Komunës, ndërsa drejtorët emërohen nga Kryetari dhe u përfundon mandati me përfundimin e mandatit të Kryetarit dhe po ashtu ata mund të zëvendësohen apo shkarkohen nga Kryetari në çdo kohë.

Gjatë viteve 2010-2012, Komuna e Mitrovicës ka lidhur 603 kontrata nëpërmjet procedurave të Prokurimit Publik. Por, Komuna ka dërguar vetë 73 njoftime për lidhje të kontratave në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, çka do të thotë se mbi 80% e kontratave dhe shpalljes së tenderëve nuk janë dërguar për njoftim në KRPP.<sup>14</sup> Komuna krahas njoftimeve që do të duhet t'i dërgonte në KRPP njëherazi të njëjtat do të duhet t'i publikonte edhe në faqen zyrtare të Komunës së Mitrovicës. Në tri vitet e fundit në këtë faqe hasen më pak se 50 njoftime të shpallura.<sup>15</sup>

Drejtoria e Prokurimit në Mitrovicë, përveç drejtorit, ka gjithsej nëntë persona të punësuar, dy prej të cilëve mbajnë pozitën e shefit të sektorit në Drejtorinë e Prokurimit, dy zyrtarë janë përgjegjës për kontratat me vlerë të mesme dhe me vlerë minimale, dy zyrtarë të tjerë janë përgjegjës për pranimin dhe shqyrtimin e lëndëve të pranuar si dhe nga një zyrtar mbajnë pozitën e menaxhimit të kontratave dhe zyrtar administrativ.

Tabela nr.10: Kontratat e Prokurimit në Komunën e Mitrovicës 2010 -2012

Viti	Nr. i kontratave	Vlera e kontratave (euro)
2010	111	4.934.965,74
2011	347	3.955.112,57
2012	145	2.464.909,63
Gjithsej	603	11.354.987,94

Gjatë tri viteve të fundit, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka vërtetuar në disa raste se Komuna e Mitrovicës ka shpërfillur rregullat e prokurimit publik gjatë shpalljes së tenderëve apo lidhjes së kontratave. Rasti i fundit ka të bëjë me ndërtimin e shkollës "Sylejman Vokshi". OSHP ka anuluar tenderin dhe procedurën e lidhjes së kontratës me arsyetimin se nuk janë respektuar kriteret e prokurimit.<sup>16</sup> Vendim dhe arsyetim i

<sup>14</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. Komuna e Mitrovicës. 2010. 2011. 2012. Burimi:

<sup>15</sup> Komuna e Mitrovicës. Faqja zyrtare ne internet. Prokurimi Publik. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Prokurimi/Njoftim-per-kontrate.aspx?page=1>

<sup>16</sup> Organi Shqyrtues i Prokurimit. Vendimet e shpallura. Komuna e Mitrovicës. 2012. Burim: <http://oshp.rks-gov.net/repository/docs/vendimet/2012/Ndertimi-i-objektit-te-shfmu.pdf>

njëjtë i OSHP është dhënë edhe në rastet, “Rregullimi i kanalizimit fekal në lagjen Përroi i Vitakut”, pastaj në rastin e “Punimi dhe vendosja e shtatores se Isa Buletinit” si dhe në rastin “Ndërtimi i Zyrave të vendit në Shupkocv dhe Vinarc”.

## 6. Administrata e Komunës së Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka gjithsej 299 persona të punësuar në administratën komunale, duke përfshirë të punësuarit në Qendrën për Punë Sociale dhe në institucionet kulturore të qytetit.<sup>17</sup> Ndërsa së bashku me sektorin e arsimit, ku përfshihen të punësuarit në çerdhen e qytetit, në shkollat fillore dhe ato të mesme si dhe në sektorin e shëndetësisë, numri i të punësuarve në institucionet publike komunale në Mitrovicë është 1.910 persona.

Tabela nr.11: Numri i të punësuarave në administratën komunale në Mitrovicë dhe ndarja sipas kualifikimit shkollor dhe këndvështrimit gjinor

Më shkollë fillore	Më shkollë të mesme	Më shkollim të lartë	Më Diplomë universitare	Gjithsej	F	M
2	168	17	112	299	111	191

Tabela nr.12: pasqyrimi i numrit të te punësuarave në sistemin arsimor në Mitrovicë dhe ndarja sipas kualifikimit shkollor dhe këndvështrimit gjinor

Më shkollë fillore	Më shkollë të mesme	Më shkollim të lartë	Më Diplomë universitare	Gjithsej	F	M
110	302	498	368	1278	691	587

Tabela nr.13: pasqyrimi i numrit të te punësuarave në sistemin shëndetësor në Mitrovicë dhe ndarja sipas kualifikimit shkollor dhe këndvështrimit gjinor

Më shkollë fillore	Më shkollë të mesme	Më shkollim të lartë	Më Diplomë universitare	Gjithsej	F	M
28	201	1	55	285	174	111

Nga tabelat e mësipërme haset numër relativisht i lartë i personave të punësuar të cilët nuk kanë përgatitje universitare. Kësisoj, nga gjithsej 1.862 persona të punësuar në administratën komunale, në shëndetësi dhe arsim, 140 prej tyre janë me shkollim fillor, 671 me shkollim të mesëm, 516 me shkollim të lartë dhe 535 me diplomë universitare.<sup>18</sup>

Numri prej 516 personave të kualifikuar me shkollim të lartë, shumica dërmuese e tyre janë të punësuar në sistemin arsimor. Titulli “shkollim i lartë” është dhënë para viteve ‘

<sup>17</sup> Nga numri prej 299 personave te punësuar ne Komunën e Mitrovicës nuk

<sup>18</sup> Numri prej 1.862 nuk është i përfshi edhe numri i personelin në çerdhen e qytetit prej 48 personave.

'90 dhe atë kryesisht e kanë fituar personat që kanë ndjekur shkollën e ashtuquajtur normale duke përfshirë edhe një vit fakultet në degën e gjuhësisë apo të letërsisë.

Komuna e Mitrovicës gjatë muajit shkurt të këtij viti ka shpërfillur një vendim të Gjykatës Komonale në Mitrovicë dhe po ashtu rekomandimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që kërkonin nga udhëheqja e komunës të mos pengohet televizioni lokal "TV Mitrovica" në ushtrimin e funksionit të saj në objektin afër sheshit "Adem Jashari". Edhe për kundër këtij vendimi dhe rekomandimi nga MAPL, Komuna e Mitrovicës e ka përjashtuar me forcë personelin e këtij televizioni nga objekti.<sup>19</sup>

## 7. Arsimi në Komunën e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka një çerdhe publike, 31 shkolla fillore, disa prej të cilave kanë paralele të ndara duke bërë kështu që Mitrovica të numërojë 42 objekte të shkollave fillore. Po ashtu në këtë komunë funksionojnë pesë shkolla të mesme. Ndonëse me vetëm një çerdhe publike, ajo konsiderohet të jetë e kapacitetit relativisht të madh duke bërë kështu që mbi 300 fëmijë të sistemohen në të. Investimet në sferën e arsimit në Komunë të Mitrovicës në tri vitet e fundit kanë qenë të kënaqshme dhe ato kryesisht janë fokusuar në rregullimin e oborreve, shtimin e anekseve shkollore dhe në riparime të ndryshme.

Tabela: nr.14: Numri i fëmijëve dhe i personelit në çerdhen e Mitrovicës dhe vështirimi gjinor

Numri i fëmijëve	F	M	Numri i edukatoreve	F	M	Personeli ndihmës	F	M
326	152	174	30	29	1	18	14	4

Tabela nr.15: Numri i mësimdhënësve dhe stafit përcjellës në 42 shkollat fillore dhe pesë shkolla të mesme të Mitrovicës:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla të mesme	
	Mësimdhënës	Stafi ndihmës	Mësimdhënës	Stafi ndihmës
Femra	435	20	131	8
Meshkuj	281	169	143	43
<b>Gjithsej</b>	<b>716</b>	<b>189</b>	<b>274</b>	<b>51</b>

<sup>19</sup> Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shkrese shpjeguese. 22.02.2013. drejtuar Komunës së Mitrovicës. Burimi: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/28bd3196-cd95-4214-8f4e-8587765321e4/Shkrese-shpjeguese--zbatimi-i-vendimit-te-Gjykate.aspx>

Tabela nr.16: Numri total i mësimdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në 42 shkolla fillore dhe pesë shkolla të mesme në Komunën e Mitrovicës

Kategoria	Numri	F	M
Mësimdhënës	990	566	424
Nxënës	18.345	8.794	9.551
Stafi ndihmës	240	28	212

Tabela nr.17: Disa nga investimet kryesore në shkollat e Mitrovicës gjatë periudhës 2010 -2012

Investimet	Shuma
Rregullimi i oborrit dhe kanalizimit në Gjimnazin "Frang Bardhi"	46.870
Renovimi i shkollës "Meh Uka" në Bajgor	15.012
Rregullimi i oborrit të shkollës "Arkitekt Sinani"	12.699
Renovimi i brendshëm i shkollës "Skënderbeu"	28.464
Rregullimi i dyshemesë në Gjimnazin "Frang Bardhi"	60.050
Renovimi i brendshëm i shkollës "Fadil Grajçevci"	9.000
Ndërtimi i shkollës fillore "Sylejman Vokshi" në Brodeniq	70.986
Instalimi i kamerave në shkollën "Hasan Prishtina"	3.557
Gëlqerosja e objekteve të shkollave të mesme	22.121
Rregullimi i ngrohjes në shkollën fillore "Elena Gjika"	34.965

## 8. Transparenca në Komunën e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës gjatë tri viteve të fundit, 2010-2012, ka përmirësuar dukshëm nivelin e transparencës komunale. Ueb faqja zyrtare e Komunës posedon materiale dhe informata bazike për shumicën e sferave që mbulon Komuna. Mbeten të pamjaftueshme publikimet që lidhen më raportet e shpenzimeve të parasë publike. E kënaqshme ka qenë edhe përgjigja e Komunës në kërkesat e Institutit GAP për qasje në dokumentet publike.

Po ashtu vlerësohet e kënaqshme edhe sasia e informatave që korrespondentët e mediave të shkruara marrin nga Zyra për Marrëdhënie me Publikun. Komuna e Mitrovicës, krahas zyrtarit kryesor për informim, ka të punësuar edhe një person i cili ekskluzivisht është përgjegjës për t'u përgjigjur në kërkesat për qasje në dokumentet publike, duke e bërë këtë çështje me të lehtë për palët që janë të interesuar për t'u qasur në dokumentet me rëndësi publike.

Pasqyrime të detajuara për zhvillimet në Komunë të Mitrovicës bëjnë mediat lokale, si televizioni "TV Mitrovica", Radio "Mitrovica" dhe Radio "Ylberi". Këto media



mbulojnë gjerësisht zhvillimet e përditshme në Komunën e Mitrovicës si dhe pasqyrojnë kohë pas kohe problematikat e ndryshme në këtë komunë.

Tabela: nr.18: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Mitrovicës

<http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	√
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	√	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Arsimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	x	x	x	√	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Inspektionit	x	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Shërbime Publike	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	√	x
Planifikim dhe Urbanizëm	x	x	x	x	x	x	x	√	x	x	x	√
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Bujqësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	x	x	x	√	x	x	x	√	√	x	x	√
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik	x	x	x	√	x	x	x	√	x	x	√	x
Drejtoria e Prokurimit	x				x				√			
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x				x				x			
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	√				√				√			
Rregulloret Komunale	√				√				√			
Vendimet e Kuvendit Komunal	√				√				√			
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√											
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	X	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	√											

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 9. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009, kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Avni Kastrati, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në fund të vitit 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 13 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Mitrovicës, 4 premtime janë përmbushur, 5 tjera nuk janë përmbushur, ndërsa në 4 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2012
Asfaltimin apo rregullimin e rrugëve në relacionet: Bajgorë-Kovaqicë, Vidishic- Selac, Mazhiq-Rashan-Pasomë, Kaqandoll - Rëzhanë dhe Melenicë - Zabërgjë	Në rrugën Bajgore - Kovaqice nuk është investuar asgjë, rruga mbetet e pa asfaltuar. Në rrugën Vidishiq - Selaq - është premtuar asfaltim mirëpo deri më tani rruga është shtruar vetëm me zhavorr. Rruga që lidh rajonin e Shalës së Bajgores përmes Mazhiq-Rashan-Pasom me Vushtrinë nuk është asfaltuar. Në rrugën Kaqandoll - Rëzhanë, nuk është investuar asgjë; kjo rrugë është jo-funksionale, për më tepër në fshatin Rëzhanë nuk ka asnjë banor. Për rrugën Melenice- Zabergj - është premtuar asfalt mirëpo deri më tani rruga është shtruar vetëm me zhavorr. Premtim i pa përmbushur.
Lirimin e banesave të shqiptarëve që janë të uzurpuara në veri të Mitrovicës	Gjatë tri viteve të fundit komuna nuk ka ndërmarr asnjë hap për lirimin e banesave të shqiptarëve që janë uzurpuar në veri, edhe pse një gjë të tillë e kishte premtuar. Edhe pas 13 vjetëve shqiptarët të cilët kanë banesat e tyre në pjesën veriore të qytetit, ende vazhdojnë të jetojnë në pjesën jugore. Ata, këtë jetesë e realizojnë me buxhet të vetin, pa asnjë përkrahje nga komuna. Madje edhe shpenzimet e rrymës, ujit dhe shpenzimeve tjera që më herët paguheshin nga komuna nuk paguhën më. Premtim i pa përmbushur.

<p>Krijimin e kushteve më të mira për jetë duke rregulluar infrastrukturën rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimet. Zgjedhjen e Problemit për ujin e pijshëm (Projekt në bashkëpunim me Komisionin Evropian në vlerë prej 10 milion euro gjatë mandatit 4 vjeçar).</p>	<p>Në fund të vitit 2012, në qytetin e Mitrovicës, ka filluar një projekt për ri-ndërtimin e ujësjellësit të ri. Kjo po bëhet nga një donacion nga Komisioni Evropian. Nga Ujësjellësi i Mitrovicës me ujë të pijshëm furnizohet edhe regjioni i Vushtrrisë dhe ai i Skenderajt. Mitrovica që nga pas lufta vazhdon të ketë reduktime të mëdha të ujit të pijshëm. Kjo vjen si pasojë e rrjetit të dobët e gjithashtu edhe si pasojë e mospagimit me rregull. Për këtë të fundit komuna ka marr vendim që qytetarët të vet të mos iu lëshojë asnjë dokument pa e pasur dëshminë se kanë paguar ujin, mirëpo pas disa ankesave të bëra nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kjo komunë kishte vendosur që të hiqte këtë ngarkesë për qytetarët e saj. Një gjë e tillë i ka irrituar ata. Sipas mitrovicasve edhe komuna e Vushtrrisë dhe ajo e Skenderajt furnizohen nga po i njëjti ujësjellës. Atëherë sipas tyre kjo ndalesë duhet të bëhet edhe për banorët e atyre komunave. Edhe përkundër kësaj ndalese, shumë zona të Mitrovicës vazhdojnë të kenë reduktime të mëdha uji. Thuajse në të gjithë komunën ka reduktime të mëdha të ujit. Pastaj është fshati Kqiç i cili ka mungesë të madhe të ujit. Edhe pse llogaritet si fshati më i madh në këtë komunë reduktimet në këtë fshat vazhdojnë të jenë 1 ditë me ujë dhe një pa të. Premtim pjesërisht i përmbushur.</p>
<p>Vazhdimin e punimeve në ndërtimin e shtëpive në veri</p>	<p>Për sa i përket ndërtimit në veri është bërë progres; gjatë mandatit qeverisës aktual janë ndërtuar mbi 180 shtëpi, kryesisht me investime direkte nga Qeveria e Kosovës, ndërsa 47 prej tyre janë ndërtuar përmes aksionit humanitar “Ndihmo edhe ti”. Por, nga investimet në veri të Mitrovicës nuk kanë përfituar fare disa lagje veriore siç është lagja e Boshnjakëve, lagja e Tre Rrokaqiejt. Premtim i përmbushur.</p>
<p>Angazhim në krijimin e një sistemi funksional shëndetësor në Komunën e Mitrovicës</p>	<p>Gjatë periudhës qeverisëse 2010-2012 në Mitrovicë ka filluar punën spitali rajonal “Dr.Sami Haxhibeqiri”, ndërtimin e të cilit e kanë mundësuar donacionet të organizatave ndërkombëtare. Mirëpo, Komuna e Mitrovicës ka mungesë të kadrove mjekësore. Pacientët ankohen edhe për shërbimin e dermatologjisë. Punëtorët e QKMF në këtë komunë gjithashtu ankohen për probleme të shumta. Përveç kushteve të rënda të punës dhe mjeteve të pakta në sanitari këta po</p>

	ballafaqohen edhe me paga. Të gjithë punëtorët që marrin pushim mjekësor nga paga e tyre iu hiqet shuma prej 44 eurove. Kjo shumë iu hiqet vetëm atyre që marrin pushim mjekësor dhe jo edhe atyre që marrin pushim vjetor. Kjo gjë për mantelbardhët e Mitrovicës është e padrejtë. Premtim i pa përmbushur.
Zgjidhjen e problemit të orarit të punës në çerdhen e vetme të fëmijëve “Gëzimi Ynë”	Komuna e Mitrovicës vazhdon ta ketë vetëm një çerdhe për fëmijë dhe e cila punonte vetëm deri në ora 16, por që nga viti 2011 kjo çerdhe ka zgjatur orarin e punës deri në ora 17:00 duke iu mundësuar shumë qytetarëve që punojmë deri në këtë kohë të bëjnë zgjidhje për kujdesin e fëmijëve të tyre. Por, premtimi për ndërtimin e një çerdheje të re publike në qytet një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Premtim i përmbushur.
Krijimin e një zone të lire ekonomike në Mitrovicë, e cila do të mundësojë gjenerim vendesh të reja pune dhe ku aktivitetet zhvilluara në këtë zonë do të kenë tatim zero	Kryetari i komunës ka caktuar një lokacion për zonën e lirë ekonomike, por në mungesë të ligjit përkatës funksionalizimi nuk ka ndodhur asnjëherë, deri më tani kjo gjë ka mbetur vetëm një premtim. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Realizimin e modelit më të mirë në vend për zgjidhjen e problemeve të pjesëtarëve të kategorive të dala nga lufta	Për pjesëtarët e kategorive të dala nga lufta, si dhe familjet e dëshmorëve, Kuvendi Komunal ka ndarë nga një tokë. Mirëpo toka e cila iu ka nda gjendet në një zonë thuajse malore ku nuk ka kurrfarë infrastrukture. Përveç kësaj ndarje dhe sigurimit të një zyre për organizatat e dala nga lufta e UÇK, këto kategori nuk kanë përfituar asgjë tjetër. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Ndërtimin e një universiteti evropian në Mitrovicë mbështetje për fakultetet në Mitrovicë dhe hapjen e drejtimeve të tjera, si psh. Fakultetin Edukimit, Mjekësisë etj.	Kuvendi komunal në një nga mbledhjet e tij ka ndarë një pjesë të tokës në të cilën është destinuar ndërtimi i një shkolle elite. Toka është ndarë nga pjesa që dikur është quajtur ‘Fidanishtja’ për ndërtimin e fakultetit të FXM që është pjesë e Universitetit të Prishtinës. Mirëpo përveç këtyre ndarjeve të tokave, asgjë konkrete nuk është bërë në këtë drejtim. Sa i përket hapjes së drejtimeve të reja, deri më tani nuk ka pas asnjë lëvizje në këtë drejtim. Premtim i pa përmbushur.
Mbështetje për shoqatën e familjeve të të pagjeturve “Kujtimi”	Shoqata e Familjeve të të pagjeturve nuk e ka përkrahjen e duhur nga Komuna e Mitrovicës. Ndihma e vetme që ka pasur kjo shoqatë

	nga komuna është sigurimi i një zyre. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Për fshatin Vinarc asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave, zonën rekreative shumë të bukur me një liqe dhe shetitore në të dy anët e lumit, e cila do t'i japë epitelin e një fshati turistik dhe do të sjellë përfitimime për banorët e këtij fshati	Mjetet e destimitit për asfaltimin e të gjitha rrugëve dhe rrugicave, mirëpo është asfaltuar vetëm rruga kryesore, po ashtu në bashkëpunim me Komisionin Evropian, është financuar punimi i një zone rekreative me një liqen artificial në këtë fshat, punimet kanë filluar dhe janë në zhvillim e sipër. Premtim i përmbushur.
Kushte më të mira për pensionistët	Nga qeverisja lokale, pensionistët e Mitrovicës deri me tani anë përfituar një zyrë por nuk kanë pasur asnjë përkrahje tjetër. Premtim pjesërisht i përmbushur.
Rregullimin e Sheshit Qendror me vlerë prej 700.000 Euro	Nuk është bërë asgjë në këtë drejtim. Premtim i pa përmbushur.

## 10. Burimet

1. Komuna e Mitrovices. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti financiar për periudhen janar – dhjetor 2011. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Reguloret-dhe-Pasqyrat-Komunale.aspx>
2. Komuna e Mitrovices. Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Raporti financiar për periudhen janar – dhjetor 2012. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Projects/Budget/Raporti-financiar-per-vitin-2012.aspx>
3. Komuna e Mitrovicës. Drejtoria e Administratës. Lista e të punësuarave në sektorët publik në Mitrovicë. 2012.
4. Raportet vjetore të Koomisionit Rregullativ të Prokurimit Publik - [http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu\\_OpenNode=90](http://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=1&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCAnnual&PPRCMenu_OpenNode=90)
5. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet për lidhjen e kontratave përmes prokurimit publik nga Komuna e Mitrovicës. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/>
6. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
7. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)
8. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Lista e rezultateve për zgjedhjet lokale të vitit 2009. Burimi: [http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk\\_raundi%202.pdf](http://www.kqz-ks.org/SKQZ-WEB/al/zgjedhjetekosoves/materiale/rezultatet2009/kryetar/rezultatetkk_raundi%202.pdf)
9. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
10. Organi Shqyrtues i Prokurimit. Tabela me njoftimet e shpallura. Komuna e Mitrovicës. 2010, 2011, 2012. Burimi: <http://oshp.rks-gov.net/?cid=1,71>
11. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetikomunal.aspx>
12. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Mitrovicës për vitin 2011. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit\\_KMT\\_2011\\_Shqip\\_909111.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KMT_2011_Shqip_909111.pdf)
13. Komuna e Mitrovices. Faqja Zyrtare në internet. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/mitrovice/Home.aspx>
14. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal. Shkrese shpjeguese. Burimi: <http://mapl.rks-gov.net/getattachment/28bd3196-cd95-4214-8f4e-8587765321e4/Shkrese-shpjeguese---zbatimi-i-vendimit-te-Gjykate.aspx>